



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 3.

Prishtinë, më 29.12.2014 në ora 8:30.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Valdete Bajrami, Ilir Deda dhe Kujtim Paçaku

Munguan Blerim Shala, Rustem Mustafa,, Arben Gashi, Luljeta Veselaj - Gutaj dhe Slllobodan Petroviç

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqia– kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Kryetarja: tha pasi raporti me amendamente nga Komisioni funksional i është shpërndarë sot për seancë plenare ne nuk mund ti shqyrtojmë tani këto amendamente të cilat janë në numër mjafttë madh, andaj ne do të dalim me rekomandime si komision vetëm për projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe lidhur me këtë hapi debatin.

Vjosa Osmani: tha se raporti ka ardh pak para seancës dhe në raport nuk janë përfshirë të gjitha amendamentet të cilat i kanë bërë deputetët ,i kam dërguar amendamente në Komisionin për buxhet të mërkurën por ato nuk qenkan përfshirë në raport , sepse pas të martës amendamentet e deputetëve nuk janë përfshirë dhe nuk kuptoj se si në mënyrë selektive është bërë raporti.

Po ashtu edhe **Xhavit Haliti** tha se jam munduar ti dërgoj 3 amendamente në Komision ,por më than se nuk do ti marinë parasysh.

Ilir Deda: propozoj Kryetare që ta harmonizojnë tekstin me propozimet e bëra në mbledhjen e kaluar dhe të dalim me kohë me rekomandime si komision.

Kryetarja: tha se po ja shtojm pavarësin buxhetore ,pastaj nuk kanë ardh amendamentet me kohë dhe po e kompletojmë dhe po ju dërgojmë direkt deputetëve

Vjosa Osmani: kërkoj kryetares ta merë fjalën në seancë kur të hapet debati dhe ti paraqet vërejtjet e Komisionit.

Xhavit Haliti: vlerësoj se ana politike duhet ta trajtoj fort pavarësimin e buxhetit, arsyeja pse duhet pavarësuar buxheti dhe pse na kanë kritikuar qe dy legjislatura.

Kryetarja: konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 05-L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.
2. Raporti me amendament nuk ka ardhur me kohë për shqyrtim.
3. Në Projektligjin nr. 05-L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 nuk është paraparë pavarësia buxhetore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkesë e Raportit të Progresit dhe Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.
4. Buxheti i ndarë për vitin 2015 për Ministrinë e Integrimit Evropian krahasuar me projeksionin e viteve 2016 dhe 2017 është më i madh, prandaj do të duhej të kishte një sqarim nga Ministria e Integrimit Evropian për projeksionet apo vlerësimet për vitin 2016 dhe 2017. Po ashtu, kjo Ministri nuk ka paraparë asnjë projekt për vitin 2015.
5. Mungesa e pjesës narrative apo përshkruese e shifrave tabelore e bënë mjaft të vështirë analizimin e Projektligjit për Buxhetin, prandaj në të ardhmen do të duhej të përcillej me narrativ- përshkrim.
6. Shqetësuese mbetet edhe mungesa e ndarjes së mjeteve financiare në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, për arritjen e objektivave të parapara në Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj. Teuta Sahatqia
